


Kriza energjetike në
Ballkanin Perëndimor:
Masat e ndërmarra në
kohën e rritjes së
çmimeve të energjisë



Kriza energjetike në Ballkanin Perëndimor: Masat e ndërmarra në kohën e rritjes së çmimeve të energjisë

 **HEINRICH BÖLL STIFTUNG**

Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Heinrich-Böll-Stiftung.

ABSTRAKT

Dokumenti hulumtues “Kriza energjetike në Ballkanin Perëndimor: Masat e ndërmarra në kohën e rritjes së çmimeve të energjisë” paraqet një analizë të navigimit të krizës energjetike dhe masat e duhura, të ndërmarra nga qeveritë përkatëse, për ta trajtuar rritjen e çmimeve në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Analiza së pari merr parasysh si po zhvillohet kriza në kontekstin evropian dhe atë global. Analiza i vlerëson faktorët që mund t’i kenë kontribuar krizës energjetike në Ballkanin Perëndimor dhe ndikimin e tyre në popullsinë e rajonit. Ky studim argumenton se kërkesa në rritje për energji dhe rritjet e çmimeve kanë ndikuar negativisht te njerëzit, bizneset dhe veçanërisht te gratë dhe komunitetet e prekura nga varfëria energjetike. Rritja e kërkesës për energji elektrike gjithashtu ka krijuar pasiguri rreth synimeve klimatike të secilit vend, të zotuarra nën Agjendën e Gjelbër të Deklaratës së Sofjes. Për këtë qëllim, analiza synon ta portretizojë një pamje të vendeve më të prekura nga rritja e çmimeve dhe të vendeve që i ndërmorën masat e duhura në kohën e duhur në Ballkanin Perëndimor.

Analiza përdor një metodologji të përzier që përbëhet nga takime me përfaqësues të qeverive të vendeve të BP6 dhe organizatave ndërkombëtare, të dhënat dytësore nga raportet e fundit mbi krizën energjetike dhe një kontakt me zyrat kombëtare rregullatore të energjisë në rajonin e BP6 për të mbledhur të dhëna. Mbledhja e të dhënave të nevojshme nga institucionet e vendeve të BP6 për një analizë krahasuese ka qenë mjaft sfiduese, kështu që shumë herë kontributi nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Komuniteti i Energjisë ka qenë i rëndësishëm për nxjerrjen e rezultateve të theksuara në analizë.

Disa nga rekomandimet që dalin nga analiza përfshijnë një bashkëpunim më të fortë rajonal ndërmjet vendeve të BP6, mbështetje

për konsumatorët në varfëri energjetike dhe bizneset me energji intensive, rritjen e transparencës dhe të cilësisë së informacionit lidhur me krizën energjetike dhe punën me shpejtësi të plotë drejt një tranzicioni të drejtë energjetik në rajon.

LISTA E SHKURTESAVE

ABRRE	Agjencia për Bashkëpunim të Rregullatorëve Energjetik
CO₂	Dioksid karboni
CP	Palë kontraktuese (e Traktatit të Komunitetit të Energjisë)
OPSH	Operator i sistemit të shpërndarjes
MGJE	Marrëveshja e Gjellbër Evropiane
EnC	Komuniteti i Energjisë
ENTSO-E	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji
BE	Bashkimi Evropian
EUR	Euro
FBeH	Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
HUPX	Bursa Hungareze e Energjisë
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuíim me Energji Elektrike
GNL	Gaz natyror i lëngshëm
MWh	Megavat orë - sasia e energjisë elektrike e prodhuar në një periudhë kohore
PKEK	Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës
BER	Burimet e Energjisë së Ripërtëritshme
RS	Republika Serbe
KJG	Korridor i Jugor i Gazit
GTA	Gazsjellësi Trans-Adriatik
OST	Operator i Sistemit të Transmetimit
BP	Ballkani Perëndimor
BP6	Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor

Përmbajtja

Abstrakt	1
Lista e shkurtesave	3
Hyrje në krizën energjetike	7
Perspektiva globale	7
Faktorët kryesorë që ndikojnë në krizën energjetike	8
Rimëkëmbja pas COVID-it	8
Rezervat e shteruara të energjisë nga lëndët djegëse fosile	9
Kushtet ekstreme të motit	9
Pushtimi i Ukrainës	10
Perspektiva e Ballkanit Perëndimor	10
Ndikimet e krizës energjetike në Ballkanin Perëndimor dhe masat e ndërmarra	15
Ndikimi mjedisor	15
Ndikimi ekonomik: Profilet energjetike të vendeve	16
Shqipëri	16
Bosnje dhe Hercegovinë	17
Kosovë	18
Mal i Zi	19
Maqedoni e Veriut	20
Serbi	21
Ndikimi ekonomik: Analizë krahasuese e ndikimit dhe masave	22
Ndikimi social	28
Konkluzion	31
Rekomandime	33

HYRJE NË KRIZËN ENERGJETIKE

A. Perspektiva globale

Kriza energjetike është kthyer në pengesë serioze në furnizimin e burimeve energjetike të nevojshme për rritjen normale të PBB-së dhe po bëhet faktor shumë kufizues për çdo ekonomi në botë. Për shkak të kostove të larta të energjisë, ekziston frika e recesionit global ekonomik, përveç rritjes së shqetësimeve për ndryshimet klimatike për shkak të rritjes së vazhdueshme të emetimeve fosile. Energjia është burim parësor për të gjitha aktivitetet ekonomike dhe një kontribut i domosdoshëm, duke u shtuar vlerë të gjitha proceseve ekonomike në zinxhirin e vlerës. Si e tillë, çdo ekonomi është e prirur ndaj çmimit të luhatshëm të këtij burimi jetik. Kjo luhatje, veçanërisht kur bëhet më e shtrenjtë ose e kufizuar në sasi, mund të manifestohet në më shumë shpenzime për prodhimin e shërbimeve ose produkteve të caktuara në ekonominë e përgjithshme, të cilat, nga ana tjetër, do të kushtojnë më shumë në treg dhe rritja e çmimit për këto produkte/shërbime do ta rrisë, më pas, përqindjen e inflacionit.

Gjysma e dytë e vitit 2021 u shënua me rritje të paprecedentë të çmimeve në tregjet evropiane të energjisë elektrike dhe energjisë në përgjithësi. Në shumicën e vendeve të BE-së, çmimet e energjisë elektrike me shumicë janë rritur për 200% çdo vit, që nga fillimi i krizës. Bursa Hungareze e Energjisë Elektrike (HUPX) – e marrë si referencë për shkak të afërsisë gjeografike dhe likuiditetit të saj, arriti një vlerë rekord prej 850 €/MWh më 24 gusht 2022, që përfaqëson një çmim të ri të lartë rekord të energjisë elektrike që nuk është parë më parë në tregun e ditës në avans.

Shumica e vendeve evropiane kanë ndërmarrë një sërë masash për t'i mbrojtur ekonomitë e tyre dhe grupet sociale të cënueshme nga efektet e krizës. Disa nga këto masa përfshijnë subvencione dhe programe të mbrojtjes sociale për segmentet e shoqërisë së prirur ndaj varfërisë energjetike, mbështetje për NVM-të (p.sh. Rumania, Republika Çeke) etj. Sllovenia, për shembull, ka prezantuar një paketë mbështetëse që përbëhet nga një shkurtim i përkohshëm i akcizave për karburante, naftën për ngrohje dhe gazin, dhe të ardhura prej 150 eurove për individët që marrin ndihmë sociale, mbështetje për fëmijët dhe punëtorët me të ardhura më të vogla se 680 euro dhe për familjet me katër ose më shumë fëmijë, të ardhura prej 200 eurove.

Pavarësisht masave të shumta të ndërmarra për ta lehtësuar barrën ekonomike të krizës, shumica e familjeve në BE janë ndikuar rëndë si nga këto kosto të larta të energjisë, ashtu edhe nga kriza ekonomike e shkaktuar nga COVID-19. Tranzicioni energjetik i nevojshëm për t'i parandaluar pasojat katastrofike të ndryshimeve klimatike dhe për ta ulur varësinë e BE-së nga lëndët djegëse fosile dhe ndjeshmërinë e saj ndaj ndryshimeve në çmimet e lëndëve djegëse fosile po minohet nga ndikimi që kriza energjetike ka pasur në BE.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në krizën energjetike

Rimëkëmbja pas COVID-it

Bllokimi dhe masat anti-COVID gjatë pandemisë e kishin ulur aktivitetin ekonomik në nivel global, me kërkesën, konsumin dhe furnizimin të ulur në mënyrë dramatike. Pas disa kohësh, kjo u pasua nga lehtësimi i masave të bllokimit, të cilat, nga ana e tyre, çuan në një rritje të aktivitetit ekonomik, e kombinuar me pamundësinë e furnizimit për ta ndjekur një rritje të madhe të kërkesës. Edhe pse sektori i

energjisë së ripërtëritshme ka qenë në rritje gjatë pandemisë, pandemia e ngadalësoi përparimin e saj për shumë vende, veçanërisht në Azi dhe Afrikë.¹

Rezervat e shteruara të energjisë nga lëndët djegëse fosile

Rezervat e ulëta të energjisë nga lëndët djegëse fosile e kanë rritur edhe më shumë krizën energjetike në Evropë, kryesisht për shkak të kapacitetit më të ulët të prodhimit të lëndëve djegëse fosile. Që nga viti 2010 ka pasur një prirje rënëse për lëndët djegëse fosile, gazin natyror, naftën dhe lëndët e tjera të paripërtëritshme (-16,5% për lëndët djegëse fosile; -21,2% për gazin natyror; dhe -5,2% për naftën dhe produktet e saj). Që nga viti 2010, gazi natyror ka pasur rënien më të madhe prej afro 63%, dhe lëndët djegëse fosile 43%. Energjia e ripërtëritshme, nga ana tjetër, ka pasur një trend pozitiv (+3,0%) bashkë me mbetjet e paripërtëritshme (1,6%).² Pavarësisht angazhimeve të BE-së, tranzicioni i energjisë nuk ndodhi mjaft shpejt.

Kushtet ekstreme të motit

Një sërë kushtesh ekstreme të motit, kryesisht për shkak të ndryshimeve klimatike, e kanë ndërlikuar edhe më tej krizën energjetike. Dimri në vitin 2020-2021 ishte jashtëzakonisht i ftohtë në Evropë dhe Azi, dy tregjet kryesore konkurruese për gazin natyror GNL, dhe vera ishte jashtëzakonisht e nxehtë në tërë Evropën, Azinë dhe Shtetet e Bashkuara. Kjo e ngriti kërkesën për ajër të kondicionuar dhe ngrohje në nivele të larta të paprecedentë, që gjithashtu e rriti konsumin e

¹ Organizata Botërore e Shëndetësisë, *Ndjekja e SDG7: Raporti i progresit të energjisë*. 30 maj 2022. Marrë nga: <https://www.who.int/publications/m/item/tracking-sdg7--the-energy-progress-report-2022>

² Eurostat, *Statistikat e energjisë - një pasqyrë*. Shkurt 2022. E qasshme në: https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Energy_statistics_-_an_overview

energjisë elektrike³. Kushtet ekstreme të motit e kanë ngadalësuar përparimin e rajoneve drejt energjisë së ripërtëritshme dhe kanë shkaktuar vështirësi për shkak të *pushtimit rus të Ukrainës* në furnizimin me energji për familjet.

Pushtimi i Ukrainës

Pushtimi aktual rus i Ukrainës e ka përkeqësuar edhe më tej krizën globale energjetike. Sulmi i ngriti çmimet e naftës dhe të gazit në nivele të paprecedentë, duke i shtyrë shumë vende të mendojnë për miksin e tyre energjetik. Rusia, eksportuesi më i madh në botë i naftës dhe gazit, eksporto i 40% të gazit të saj natyror dhe 27% të naftës në Evropë në vitin 2021, duke i plotësuar nevojat e tyre.⁴ BE, bashkë me shumë vende të tjera, kanë vendosur sanksione të rrepta ekonomike ndaj Rusisë dhe janë zotuar të heqin dorë nga nafta dhe gazi natyror rus. SHBA-ja ka vendosur një ndalim të plotë të naftës dhe gazit natyror rus. Kjo çoi në mungesën e shumë mallrave energjetike dhe në rritje të çmimeve.

B. Perspektiva e Ballkanit Perëndimor

Ballkani Perëndimor është një rajon i cenueshëm posaçërisht për sa i përket ndikimit të krizës energjetike dhe pushtimit të Ukrainës. Shumica e vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor varen nga përdorimi i lëndëve djegëse fosile, posaçërisht qymyrit të kaftë për nevojat e tyre energjetike, megjithatë, ato janë më pak të varura nga gazi rus si burim i drejtpërdrejtë i energjisë, krahasuar me rajonet e tjera të Evropës. Duhet të theksohet se sipas të dhënave të ABRRE-së të vitit 2020, varësia nga gazi rus është 89% në Serbi; 100% në BeH; dhe 100%

³ Instituti i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë, *Rebusi i krizës energjetike në Evropë Origjina, ndikimi dhe rruga përpara*. 28 janar 2022. Marrë nga:

<https://www.iss.europa.eu/content/europes-energy-crisis-conundrum>

⁴ BBC News, *Sanksionet e Rusisë: Si mund të përballojë bota pa naftën dhe gazin e saj?* Shtator 2022. Marrë nga: <https://www.bbc.com/news/58888451>

në Maqedoninë e Veriut.⁵ Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë vende që varen shumë nga qymyri për prodhimin e energjisë elektrike.




Fig. 1. Pjesa e qymyrit në prodhimin e energjisë elektrike në BP6

Pjesa e tyre e qymyrit në prodhimin e energjisë elektrike sillet prej rreth 44% për Malin e Zi, 60% për Maqedoninë e Veriut, 63% për BeH-në, 68% për Serbinë deri në 95% për Kosovën.⁶ Ndërsa prodhimi i energjisë elektrike në Shqipëri varet pothuaj tërësisht nga hidrocentralet, me një përqindje shumë të vogël të energjisë diellore. Edhe pse gazi kalon nëpër Shqipëri, nëpërmjet GTA-së, ajo nuk është e lidhur me këtë gazsjellës. Qytetet e rajonit vazhdojnë të renditen ndër

⁵ BNE IntelliNews, *Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Moldavia më të varurur nga gazi rus*. 8 shkurt 2022. Marrë nga: <https://www.intellinews.com/north-macedonia-bosnia-and-moldova-most-dependent-on-russian-gas-234239/>

⁶ EMBER, *Data Explorer, Prodhimi i energjisë elektrike në botë sipas burimit*. E qasshme në: <https://ember-climate.org/data/data-explorer/>; 2021 Data from Kosovo's ERO shows that the share of coal in electricity generation is now 93%

më të ndoturat në Evropë, ku qytetarët humbasin deri në 1,3 vjet jetë nga ndotja e ajrit.⁷ Kostot e vlerësuara për shëndetin publik në vitin 2020 nga termocentralet me qymyr sillleshin prej 6 miliardë deri në 12,1 miliardë euro. Kjo kosto përballohet nga BP6, si dhe qytetarët e BE-së përmes kostove personale për trajtime dhe rritjes së buxheteve kombëtare për kujdesin shëndetësor⁸.

BP6 është më i prirur ndaj luhatjeve në tregjet e energjisë elektrike dhe kjo është nxjerrë në pah si rezultat i krizës energjetike. Çmimi i energjisë në bursën e energjisë po rritet në nivele rekord (siç tregohet në Fig. 1), duke vendosur rekorde të paprecedentë në rajon. Duke marrë parasysh tendencat dhe faktorët kufizues në kontinentin evropian për prodhimin e energjisë, supozohet se çmimet do të arrijnë në nivele të reja rekord gjatë dimrit.

Çmimi i energjisë për një ditë më përpara në Bursën Hungareze – HUPX, që ishte 295 EUR/MWh për javën 4-10 korrik, u rrit në 348 EUR/MWh për javën 11-17 korrik, dhe në 419 EUR/MWh për javën 18-24 korrik. Për tri ditët e para të javës 25-31 korrik, çmimi ishte 464 EUR/MWh. Çmimi rekord i pikut u thye më 30 gusht, duke arritur në mbi 1047,1 EUR/MWh në orën 20:00.

⁷ Mjedisi i OKB-së, *Ndotja e ajrit dhe shëndeti i njeriut: Rasti i Ballkanit Perëndimor*. Maj 2019. E qasshme në: https://www.developmentaid.org/api/frontend/cms/file/2019/06/Air-Quality-and-Human-Health-Report_Case-of-Western-Balkans_preliminary_results.pdf

⁸ CREA & CEE Bankwatch Network. *Pajtohuni ose mbylluni, përmbledhje e vitit 2021 e shkeljeve ligjore dhe ndikimeve në shëndet*. Shtator 2021. E qasshme në: <https://energyandcleanair.org/wp/wp-content/uploads/2021/09/En-COMPLY-OR-CLOSE-How-Western-Balkan-coal-plants-breach-air-pollution-laws-and-cause-deaths.pdf>




Fig. 2. Çmimi mesatar i energjisë elektrike në korrik 2022 për BP6

Duke i marrë parasysh këta trendë të çmimeve, çmimet mund të rriten edhe më shumë në sezonin e dimrit të ardhshëm. Këto çmime të larta do të krijojnë probleme të mëdha për prodhuesit dhe konsumatorët dhe kriza ekonomike dhe recesioni do të pasonin. Përveç kësaj, ndërprerjet e energjisë elektrike, rënia e PBB-së dhe rritja e inflacionit do të ishin normalja e re për të paktën dy deri në tri vjetët e ardhshme derisa tregjet të stabilizohen.




Fig. 3. Çmimi mujor i energjisë elektrike për MWh për vitin 2020, 2021, 2022 në Bursën e Energjisë HUPX për Ballkanin Perëndimor⁹

Si të tilla, veçanërisht, gjatë periudhës së dimrit, objektet energjetike nuk kanë mundur ta plotësojnë kërkesën, duke i detyruar kompanitë e licencuara zakonisht të drejtuara nga shteti, si OST-të, të blejnë energji nga vendet e tjera për t'i parandaluar kostot e tepruara për PBB-në e përgjithshme të vendeve të tyre përkatëse dhe të përpiqen t'i shmangin ndërprerjet.

Qeveritë e vendeve të BP6 ndërmorën masa për t'i zbutur efektet negative të krizës duke filluar prej subvencioneve të qeverisë deri te ndërprerjet e energjisë elektrike. Ato do të analizohen më hollësisht në kapitujt në vijim.

⁹ Bursa Hungareze e Energjisë. Shtator 2022. E qasshme në: <https://hupx.hu/en/>

NDIKIMET E KRIZËS ENERGJETIKE NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE MASAT E NDËRMARRA

Ndikimi mjedisor

Me krizën ekonomike dhe energjetike dhe luftën në Ukrainë, vendet e BP6 janë goditur më së shumti. Nga njëra anë, ato kanë disa angazhime drejt synimeve klimatike dhe dekarbonizimit; nga ana tjetër, ato e kanë të vështirë ta ruajnë sigurinë energjetike, duke qenë se këto vende varen shumë nga gazi rus. Serbia dhe Maqedonia e Veriut po e rrisin prodhimin e energjisë me qymyr si përgjigje ndaj krizës.¹⁰ BE-ja sqaroi se planifikon ta përshpejtojë (jo ta ngadalësojë) tranzicionin e energjisë, veçanërisht në zhvillimin e kapaciteteve të energjisë së ripërtëritshme.¹¹ Vendet e BP6 duhet ta bëjnë të njëjtën gjë. Tregu i BE-së dhe BP6 janë të integruara, kështu që duhet të merren parasysh planet e BE-së kur hartohen planet dhe strategjitë kombëtare të rajonit. Në rast të mospërputhjes me këto synime, ekonomitë e BP-së, të cilat janë të lidhura ngushtë me Bashkimin Evropian, do të preken rënd nga politikat mjedisore të BE-së, përfshirë, për shembull, prezantimin e një mekanizmi për rregullimin e kufirit të karbonit. Asnjë nga vendet e rajonit ende nuk e ka miratuar një plan afatgjatë të dekarbonizimit dhe as plane për tranzicionin e energjisë, përveç Maqedonisë së Veriut, e cila e ka një datë të largimit të qymyrit në vitin 2030 dhe përmend një

¹⁰ Reuters, *Ballkani i kthehet qymyrit pasi kriza energjetike i tejkalon angazhimet për klimën*. 19 prill 2022. E qasshme në: <https://www.reuters.com/article/north-macedonia-coal-idCAL5N2WH1FU>

¹¹ EURACTIV, *BE-ja paraqet planin prej 300 miliardë eurove për t'i hequr qafesh lëndët djegëse fosile ruse, për ta përshpejtuar tranzicionin e gjelbër*. 18 maj 2022. Marrë nga: <https://www.euractiv.com/section/energy/news/eu-tables-e300bn-plan-to-ditch-russian-fossil-fuels-speed-up-green-transition/>

program të drejtë të tranzicionit si një nga masat politike në draftin e saj të PKEK-ut.

Qeveritë në BE dhe në Ballkanin Perëndimor mund ta përdorin momentin e kësaj krize energjetike dhe të luftës në Ukrainë për ta përshpejtuar tranzicionin e energjisë, për t'i mbajtur emetimet nën kontroll dhe për ta mbyllur hendekun e emetimeve në vitin 2030.¹²

Ndikimi ekonomik: Profilet energjetike të vendeve

A. Shqipëri

- Prodhimi i energjisë së instaluar në Shqipëri është 99% i bazuar në hidro. Kapaciteti i përgjithshëm është 2.496 MW me hidroenergji, nga të cilat 98 MW janë kapacitet termik që nuk janë në funksion dhe bazohen në naftë dhe rreth 20 MW janë kapacitet diellor.
- Burimet relativisht të pashfrytëzuara dhe të shumta përfshijnë energjinë diellore, e cila në Shqipëri, për shkak të pozitës së saj gjeografike, është e bollshme, dhe energjinë e erës që nuk është përdorur deri më tani.¹³
- Vend importues neto i energjisë elektrike - shumë i varur nga ciklet hidrologjike. Prodhimi në vitin 2020 ishte 5.313 GWh, ndërsa konsumi ishte 7.589 GWh.¹⁴

¹² Klima Action Tracker, *Reagimi global ndaj krizës energjetike rrezikon tranzicionin në zero karbon*. Qershor 2022. Marrë nga: https://climateactiontracker.org/documents/1055/CAT_2022-06-08_Briefing_EnergyCrisisReaction.pdf

¹³ Dena, UNECE *Përvetësimi i energjisë së ripërtëritshme: Zhvillimi i energjisë së ripërtëritshme në Shqipëri*, Qershor 2021. Marrë nga: https://unece.org/sites/default/files/2021-07/UNECE-RE_Uptake_Factsheet_Albania.pdf

¹⁴ Të dhënat e Komunitetit të Energjisë, 2020. E qasshme në: <https://www.energy-community.org/>

Masat dhe ndikimi në Shqipëri:

- Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme për sa i përket krizës energjetike dhe furnizimit me energji u bë e ditur në tetor 2021 për shkak të rritjes alarmante në trendët e çmimeve të energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare. Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme nga qeveria lejon ndërhyrjen me instrumente financiare e administrative për ta përballuar dhe parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të krizës.
- 200 milionë euro u ndanë për ta zbutur efektin e krizës energjetike për vitin 2021-2022.¹⁵
- Rritjet e tarifave të çmimeve për konsumatorët që konsumojnë më shumë se 700 kW/h janë në shqyrtim.¹⁶

B. Bosnje dhe Hercegovinë

- Miksi i energjisë elektrike i BeH-së është afërsisht 60-40% i prirur drejt burimeve termike. Kapaciteti i përgjithshëm i prodhimit është 4.529 MW, nga të cilat 2.156 MW janë energji termike. Energjia me erë është 87 MW, dhe energjia diellore është 35 MW.
- Kapacitet i pashfrytëzuar i prodhimit të energjisë me erë dhe potencial i energjisë diellore.¹⁷
- Eksportues neto i energjisë elektrike në vitin 2020, prodhimi i energjisë elektrike arriti: 15.391 GWh, ndërsa konsumi ishte 11.330 GWh.

¹⁵ Komuniteti i Energjisë, “Tregjet e energjisë elektrike në BP6”, 2022. E qasshme në: <https://www.energy-community.org/>

¹⁶ Investigative Network Albania, *Basti i humbur për energjinë elektrike, si u thanë HEC-et e Drinit me sytë nga qielli*. 24 gusht 2022. E qasshme në: <https://ina.media/?p=6259>

¹⁷ IRENA, *Perspektivat e energjisë së ripërtëritshme për energjinë e Evropës Qendrore dhe Juglindore*, 2020. Marrë nga: https://www.irena.org/-/media/Files/IRENA/Agency/Publication/2020/Oct/IRENA_REmap_CESEC_2020.pdf

Masat dhe ndikimi në BeH:

- Në vitin 2021, BeH miratoi një ndryshim në Ligjin për energjinë elektrike që e kufizon rritjen e çmimit të energjisë elektrike në një maksimum prej 20% për klientët e pranueshëm.
- Në vitin 2022, RS miratoi një konkluzion që mundëson furnizimin e të gjitha shkollave me energji elektrike.
- Një rritje në tarifat e rrjetit. Konsumatorët që furnizohen nga tregu i ekspozohen rritjes së çmimit.¹⁸

C. Kosovë

- Miksi i energjisë elektrike në Kosovë është 95% i bazuar në termocentrale. Kapaciteti i përgjithshëm i prodhimit është 1.110 MW, nga të cilat 960 MW janë me bazë termike. Kapaciteti i energjisë me erë është 34 MW, ndërsa i energjisë diellore është 10 MW (të dhënat për vitin 2020).
- Potencial i madh i energjisë diellore dhe me erë, shumica e të cilave kanë qenë të pashfrytëzuara (IRENA, 2020).
- Importuesit e energjisë elektrike - veçanërisht në orët e pikut dhe në periudhën e dimrit - prodhonin 6.301 GWh, ndërsa konsumi ishte 5.771 GWh në vitin 2021.

Masat dhe ndikimi në Kosovë:

- Qeveria e Kosovës e shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në dhjetor 2021 dhe vendosi një subvencion prej 120 milionë eurove për energji elektrike.

¹⁸ Po aty.

- Ndryshimi në strukturën tarifore: Konsumatorët që konsumojnë më shumë se 800 kWh në muaj paguajnë çmime më të larta.
- Rritja e të ardhurave për USS (rreth 20% duke marrë parasysh subvencionet).
- Ndërprerje ditore dyorëshe të energjisë elektrike në dhjetor 2021. Kjo masë ka vazhduar në gusht 2022.
- 20 milionë euro për të importuar energji elektrike.

D. Mal i Zi

- Miksi i energjisë elektrike i Malit të Zi është përafërsisht i ndarë në gjysmë ndërmjet prodhimit hidro dhe termik. Kapaciteti i përgjithshëm i prodhimit është 921 MW, nga të cilat 225 MW janë me bazë termike. Kapaciteti i energjisë me erë është 118 MW.
- Potencial i lartë i prodhimit të energjisë diellore dhe me erë. Mospërdorim i energjisë diellore - potencial i pashfrytëzuar (IRENA, 2020).
- Importues i energjisë elektrike gjatë kërkesave të pikut. Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2020 ishte: 3.225 GWh, ndërsa konsumi ishte në nivelin 3.311 GWh.

Masat dhe ndikimi në Mal të Zi:

- Pritet të ketë rritje të tarifave të rrjetit.
- Asnjë masë specifike nuk është ndërmarrë që nga marsi 2022. Konsumatorët e tregut i ekspozohen drejtpërdrejt rritjes së çmimeve.¹⁹

¹⁹ Komuniteti i Energjisë, “*Tregjet e energjisë elektrike në BP6*”, 2022. E qasshme në: <https://www.energy-community.org/>

E. Maqedoni e Veriut

- Miksi i energjisë elektrike është kryesisht në favor të prodhimit termik. Ajo ka një numër relativisht të madh të hidrocentraleve. Kapaciteti i përgjithshëm i prodhimit është 2.101 MW, nga të cilat 1.321 MW janë termike, me qymyr, naftë dhe gaz. Ajo ka 37 MW të kapacitetit me erë, 24 MW diellore dhe 7 MW biogaz.
- Potencial i konsiderueshëm i erës dhe diellit që nuk është shfrytëzuar në nivel të mjaftueshëm (IRENA, 2020).
- Importues neto i energjisë elektrike. Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2020 ishte: 5.127 GWh, ndërsa konsumi i energjisë elektrike ishte 7.748 GWh.

Masat dhe ndikimi në Maqedoninë e Veriut:

- Qeveria e Maqedonisë së Veriut e shpalli gjendjen e jashtëzakonshme, 255 milionë euro mbështetje për prodhuesit dhe OST, dhe rreth 10 milionë euro për furnizim shtesë me lëndë djegëse nga TC Negotinë (central elektrik me naftë).²⁰
- Ndryshime në ligjin e TVSH-së, duke ulur taksën për furnizim me energji elektrike për familje prej 18% në 5% (do të zbatohet në qershor 2022).²¹
- Çmimet e mallrave fillimisht u ngrinë deri në dhjetor dhe më pas qeveria vendosi një kufi të çmimeve.

²⁰ Komuniteti i Energjisë, “*Tregjet e energjisë elektrike në BP6*”, 2022. E qasshme në: <https://www.energy-community.org/>

²¹ Po aty.

- 20% ulje e akcizës për lëndët djegëse dhe mbështetje e njëhershme prej 50 eurove për ata që marrin pension nën mesatare.²².

F. Serbi

- Pjesa qendrore e prodhimit të energjisë elektrike bazohet në njësitë termike. Ajo ka flotën më të madhe të prodhimit; kapaciteti i përgjithshëm i instaluar i Serbisë është 7.927 MW, nga të cilat 4.412 MW janë me bazë termike, përfshirë gazin. Kapaciteti i energjisë me erë është 398 MW, 30 MW është biogaz/biomasë, dhe diellore është 11 MW.
- Vendi ka një potencial të madh dhe të favorshëm të energjisë me erë dhe një potencial të lartë diellor që është përdorur minimalisht (IRENA, 2020).
- Vendi është eksportues neto i energjisë elektrike. Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2020 ishte në nivelin 35.626 GWh, ndërsa konsumi i përgjithshëm për atë vit ishte 32.318 GWh.

Masat dhe ndikimi në Serbi:

- Qeveria e Serbisë e vendosi kufirin e çmimeve. Çmimi i importit të gazit është vendosur në nivelin që ishte në vitin 2019. Shtesa u rikuperua në dhjetor 2021.
- Priten rritje të tarifave të rrjetit.
- Qeveria prezantoi një dekret për konsumatorët e cenueshëm të energjisë për t'i mbështetur 200.000 familje në pagesën e faturave të energjisë elektrike. 1.500 shtëpi mund të aplikojnë

²² Republika e Maqedonisë së Veriut, Ministria e Financave. *Kriza energjetike, rritja e çmimeve dhe politikat e qeverisë: Koha, fushëveprimi dhe synimi*. 13 mars 2022. Marrë nga: <https://finance.gov.mk/2022/03/13/energy-crisis-price-increase-and-government-policies-timing-scope-and-targeting/?lang=en>

për subvencione për gaz dhe 50.000 për të marrë mbështetje për kostot e ngrohjes.²³

- Në fillim të këtij viti, Ministria e Minierave dhe Energjisë në Serbi shpalli një thirrje për instalimin e paneleve diellore dhe zëvendësimin e karpentierisë. Shteti ka ndarë 230 milionë euro për ta rritur eficiencën e energjisë në vitin 2022.²⁴
- U prezantuan edhe masat për ngrirjen e çmimit të miellit, sheqerit, vajit të lulediellit, derri dhe qumështit.²⁵

Një analizë krahasuese është paraqitur në kapitullin në vijim duke i shikuar masat e ndërmarra nga secili vend i Ballkanit Perëndimor lidhur me ndikimin që ngritjet e çmimeve patën në atë vend. Analiza përpiket të hedhë dritë në atë se cili vend u godit më së shumti dhe çfarë shkoi keq për sa u përket masave të ndërmarra nga qeveria e atij vendi.

Ndikimi ekonomik: Analizë krahasuese e ndikimit dhe masave

Vendet importuese neto të Ballkanit Perëndimor janë më të prekurat nga kriza energjetike, pra Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Vendet që përdorin forma të tjera të prodhimit të energjisë elektrike, si gaz natyror ose naftë, janë përfshirë në një shkallë më të madhe. Çmimi i lartë i importit do të thotë kosto më të larta për vendet importuese neto

²³ Balkan Green Energy News, *Serbia do t'i mbrojë familjet e cenueshme nga rritja e çmimeve të energjisë*. 10 maj 2022. Marrë nga: <https://balkangreenenergynews.com/serbia-to-protect-vulnerable-households-from-jump-in-energy-prices/>

²⁴ Portali Energjetik, *Kriza energjetike dhe ndryshimet në Serbi*. 13 korrik 2022. E qasshme në: <https://www.energetskiportal.rs/en/energy-crisis-and-changes-in-serbia/>

²⁵ Republika e Maqedonisë së Veriut, Ministria e Financave. *Kriza energjetike, rritja e çmimeve dhe politikat e qeverisë: Koha, fushëveprimi dhe synimi*. 13 mars 2022. Marrë nga: <https://finance.gov.mk/2022/03/13/energy-crisis-price-increase-and-government-policies-timing-scope-and-targeting/?lang=en>

dhe ekonomitë e tyre, duke krijuar më shumë probleme me shpenzimet publike, borxhin dhe inflacionin. Nga ana tjetër, vendet eksportuese neto do të kenë fitime të mëdha në këtë situatë. Konsumatorët që janë të rregulluar do ta shohin presionin në rritje të çmimeve të larta. Në të njëjtën kohë, furnizuesit ndikohen menjëherë negativisht pasi janë të detyruar ta shesin me çmime të rregulluara gjersa blejnë në tregjet spot.²⁶



COAL



HYDROELECTRIC



BIOMASS

Lloji i prodhimit të energjisë elektrike

Shqipëria		Hidro	
Bosnja dhe Hercegovina	Qymyr	Hidro	
Kosova	Qymyr		
Mali i Zi	Qymyr	Hidro	
Maqedonia e Veriut	Qymyr	Hidro	Gaz/Naftë
Serbia	Qymyr	Hidro	

Vendi:	Importues - Neto	Eksportues - Neto	Subvencionimi i energjisë elektrike	I cenueshëm nga luhatjet e energjisë elektrike
Shqipëria	✓	✗	✓	✓
Bosnja dhe Hercegovina	✗	✓	✗	✗
Kosova	✓	✗	✓	✓
Mali i Zi	✗	✗	✗	✗
Maqedonia e Veriut	✓	✗	✓	✓
Serbia	✗	✓	✗	✗

Tabela 1. Profili i energjisë në BP6, prodhimi, importi/eksporti, subvencionet dhe cenueshmëria.

²⁶ Komuniteti i Energjisë, “Tregjet e energjisë elektrike në BP6”, 2022. E qasshme në: <https://www.energy-community.org/>

Kompanitë në tregun e hapur janë të prekura më së shumti pasi përballen me vështirësi për të operuar me çmime rekorde të energjisë. Kështu, ato janë të detyruara t'i mbyllin operacionet dhe prodhimin dhe t'i pushojnë punëtorët. Ky ka qenë rasti me disa impiante në BP6.

Është vënë re një model se sa më shumë që vendi të importojë energji elektrike, aq më shumë masa ndërmerren nga qeveritë përkatëse në përpjekje për t'i mbrojtur ekonominë dhe shoqëritë e tyre nga ndikimet negative që burojnë nga çmimet më të larta. Pasi jo të gjitha gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë të prekura në të njëjtën mënyrë nga kriza energjetike, vendet ndërmorën masa të ndryshme duke filluar nga subvencionet deri te rregullimet e tarifave të energjisë elektrike.

Përveç Bosnjës dhe Hercegovinës, Serbisë, dhe në një masë më të vogël Malit të Zi, të gjithë operatorët e rrjetit të vendeve të tjera dhe buxhetet e shtetit kanë pësuar humbje të mëdha monetare për shkak të çmimeve të larta të importit. Asnjë ndryshim në çmimin e energjisë elektrike për familje nuk është parë gjatë kohës së raportimit të analizës në Serbi dhe BeH. Për dallim nga kjo, konsumatorët familjarë nuk janë goditur ende në Shqipëri, ndonëse rritja e çmimeve duket e pashmangshme. Ka indikacione se Serbia mund t'i rishikojë edhe tarifat e energjisë elektrike.²⁷ Në Kosovë, konsumatorët familjarë ndikohen nga reforma tarifore, ku konsumatorët që konsumojnë mbi 800 kWh në muaj paguajnë çmim më të lartë. Familjet me konsum më të ulët mbrohen nga rritja derisa të parashikohet rishikimi i ri i tarifave në mars 2023. Në Maqedoninë e Veriut, pas problemeve me prodhimin e energjisë

²⁷ SeeNews, *Serbia do t'i rrisë çmimet e energjisë elektrike për familje për 6,5% nga 1 shtatori*. 28 korrik 2022. Marrë nga: [https://seenews.com/news/serbia-to-raise-power-prices-for-households-by-65-from-sept-1-793122#:~:text=BELGRADE%20\(Serbia\)%2C%20July%2028,energy%20regulator%20said%20on%20Thursday](https://seenews.com/news/serbia-to-raise-power-prices-for-households-by-65-from-sept-1-793122#:~:text=BELGRADE%20(Serbia)%2C%20July%2028,energy%20regulator%20said%20on%20Thursday)

elektrike dhe çmimit shumë të lartë të importit të energjisë elektrike, rregullatori i energjisë vendosi ta rrisë çmimin e energjisë elektrike mesatarisht për 7,4%. Do të zbatohet një format i bllok tarifave për uljen e kërkesës për energji elektrike. Duhet theksuar se kjo është hera e dytë që Maqedonia e Veriut i rrit tarifat e energjisë elektrike.²⁸ Ky është një pasqyrim i qartë i cenueshmërisë së Maqedonisë së Veriut ndaj importeve të energjisë elektrike me kosto të lartë. Vlerësohet se, nëse situata me krizën energjetike vazhdon me këtë ritëm, do të ketë ndërprerje të energjisë elektrike në Shqipëri dhe në Maqedoninë e Veriut duke filluar që nga nëntori 2022. Në Kosovë, ndërprerjet dyorëshe të energjisë elektrike kanë filluar të zbatohen në gusht 2022.

Vendi:	Rregullore për tarifa të energjisë elektrike	Të rritet tarifa e energjisë elektrike	Subvencionimi i energjisë elektrike nga shteti	Masat e varfërisë energjetike	Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme	I prekur nga rritja e çmimeve
Shqipëria	✗	✓	✓	✗	✓	✗
Bosnja dhe Hercegovina	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Kosova	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Mali i Zi	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Maqedonia e Veriut	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Serbia	✗	✓	✗	✓	✗	✗

Tabela 2. Masat e vendeve të BP6 të ndërmarra në vazhden e krizës energjetike.

Numri i masave mund të shihet si përshkrim i thellësisë së krizës energjetike që e prek një vend, dhe jo medoemos sa proaktiv është një vend në miratimin e masave të reja për ta përmirësuar situatën.

²⁸ SeeNews. *Maqedonia e Veriut i rrit çmimet e energjisë elektrike për familje*. 30 qershor 2022. E qasshme në: [https://seenews.com/news/n-macedonia-hikes-electricity-prices-for-households-789991#:~:text=Macedonia\)%2C%20June%2030%20\(SeeNews,average%20for%2098.8%25%20of%20consumers](https://seenews.com/news/n-macedonia-hikes-electricity-prices-for-households-789991#:~:text=Macedonia)%2C%20June%2030%20(SeeNews,average%20for%2098.8%25%20of%20consumers)

Konsumatorët industrialë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Serbi janë goditur drejtpërdrejt nga rritja e çmimeve, ndërsa në BeH dhe Mal të Zi nuk janë vërejtur ndryshime në tarifat e energjisë elektrike. Kjo lidhet me faktin se, me përjashtim të BeH-së dhe Malit të Zi, të gjithë konsumatorët industrialë të vendeve të tjera operojnë në tregun e lirë të liberalizuar, duke i bërë ata drejtpërdrejt të cenueshëm ndaj luhatjeve të çmimit. Disa nga këta konsumatorë po u bëjnë presion qeverive që t'i kthejnë në tregun e rregulluar; përndryshe, kjo do ta bënte të pamundur aktivitetin ekonomik, për shembull, në Maqedoninë e Veriut.²⁹

Ndryshimet sezonale të motit dhe ciklet hidrologjike i prekin drejtpërdrejt ose tërthorazi të gjitha vendet e BP6. Megjithatë, Shqipëria është më e prekura, pasi pjesa më e madhe e energjisë elektrike të saj vjen nga hidrocentralet. Vendet e tjera janë gjithashtu të prekura nga ciklet e motit, por për shkak të një mundësie më të larmishme të prodhimit të energjisë, ato nuk janë aq të prekura. Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria kanë një cenueshmëri të lartë që buron nga nevoja e tyre për të importuar energji elektrike, ndërsa Kosova është më pak e prekur në krahasim me vendet e tjera të BP6. BeH, Serbia dhe Mali i Zi, nga ana tjetër, janë shumë më pak të prekura nga çmimet e larta të importit dhe më pak të ndikuara nga luhatjet ndërkombëtare në tregjet e energjisë elektrike.

Luhatjet sezonale në modelet e motit janë të rëndësishme në përkeqësimin e krizës energjetike si një faktor i brendshëm, sepse e ulin mundësinë e vendeve për prodhim të energjisë elektrike, duke i detyruar të importojnë energji elektrike për t'i plotësuar kërkesat e tyre të brendshme.

²⁹ Po aty.



COAL



HYDROELECTRIC



BIOMASS

Lloji i prodhimit të energjisë elektrike

Shqipëria		Hidro	
Bosnja dhe Hercegovina	Qymyr	Hidro	
Kosova	Qymyr		
Mali i Zi	Qymyr	Hidro	
Maqedonia e Veriut	Qymyr	Hidro	Gaz/Naftë
Serbia	Qymyr	Hidro	

Vendi:	Importues - Neto	Nën thatësinë e vazhdueshme	Varësia nga hidro mesatarisht	I cenueshëm nga luhatjet e motit
Shqipëria	✓	✓	99%	✓
Bosnja dhe Hercegovina	✗	✗	40%	✗
Kosova	✓	✗	3%	✗
Mali i Zi	✗	✓	50%	✓
Maqedonia e Veriut	✓	✗	30%	✓
Serbia	✗	✗	40%	✗

Tabela 3. Luhatjet e motit dhe cenueshmëria në BP6.

Luhatjet e gazit natyror e prekin kryesisht Maqedoninë e Veriut, por në një shkallë më të vogël edhe Serbinë dhe BeH-në pasi ato përdorin gaz natyror për prodhimin e energjisë elektrike dhe energjisë. Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia janë më pak të prekura nga rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare të gazit në krahasim me Maqedoninë e Veriut, pasi kjo e fundit e përdor gazin natyror jo vetëm për ngrohje të hapësirave, por edhe për të prodhuar energji elektrike në një shkallë të vogël.

Ndikimi social

Rritja e çmimeve ndikon në mirëqenien e qytetarëve pasi shpenzimet përballohen kryesisht nga ata dhe bizneset. Efektet e krizës energjetike i prekin të gjitha aspektet e shoqërisë duke filluar nga inflacioni më i lartë dhe rënia e fuqisë blerëse deri te rritja e pabarazive ekzistuese dhe efektet e rrezikshme shëndetësore për shkak të ngadalësimit të tranzicionit energjetik.

Kriza energjetike i ka rritur shpenzimet e familjeve për energji dhe produkte të tjera. Sipas Studimit të Bankës Botërore mbi Krizën Energjetike në vitin 2022 dhe Anketës së Buxhetit të Familjeve, familja mesatare në BP6 shpenzon rreth 7-10% të buxhetit të saj të përgjithshëm për energji. Kjo i dobëson në mënyrë disproporcionale familjet me të ardhura të ulëta, ato të prekura nga varfëria energjetike dhe gratë.³⁰ Përdorimi i metodave tradicionale të gatimit dhe ngrohjes në shtëpi nuk është vetëm i dëmshëm për shëndetin e grave, por është edhe një kosto oportune e lartë pasi ato e kanë më vështirë të marrin pjesë në tregun e punës.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor është një nga më të prekurit kur bëhet fjalë për varfërinë energjetike. Ky pohim mbështetet nga studimi *Addressing Energy Poverty in the Energy Community Contracting Parties* [Adresimi i varfërisë energjetike në Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë] i bërë nga Komuniteti i Energjisë në vitin 2021. Studimi thekson se ndër vendet e BP6, Kosova ka pjesën më të madhe të familjeve që jetojnë në varfëri energjetike (40%). Shqipëria

³⁰ Banka Botërore. *Drejtimi përmes krizave, Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor*, Nr. 21, 2022.

<https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/37368/P17720607706c30e90841607b7d53ec8106.pdf>

pason me 37%, Maqedonia e Veriut me 33%, Serbia me 22% dhe Mali i Zi me 15%.³¹

Shpenzimet e larta për energji e rrisin cenueshmërinë e familjeve ndaj rritjes së tarifave. Ky fenomen është mjaft i zakonshëm në BP6, ku familjet me të ardhura të ulëta vonojnë t'i paguajnë faturat e tyre. Për shembull, 68% e familjeve me të ardhura më të ulëta në Kosovë dhe Maqedoni të Veriut ishin prapa me pagesat e faturave të tyre, 65% në Mal të Zi, 48% në Serbi dhe 43% në Shqipëri, krahasuar me vetëm 49%, 34%, 17 %, 8% dhe 27% për familje në familjet me të ardhura më të larta.³² Kjo do të thotë se kriza e vazhdueshme energjetike ndikon negativisht në grupet e prekura nga varfëria energjetike në nivele disproporcionale. Kjo duhet të reflektohet në masat e ndërmarra nga qeveritë e BP6.

³¹ DOOR e Komunitetit të Energjisë, EIHP, *Studim mbi adresimin e varfërisë energjetike në palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë*, 2021. Kopje fizike.

³² Po aty.

KONKLUZION

Një gërshetim i faktorëve të ndërlidhur e ka krijuar një krizë energjetike të paprecedentë dhe të shumëfishtë në nivel global. Rimëkëmbja pas pandemisë çoi në një rritje të mprehtë të kërkesës për energji dhe e ngadalësoi përparimin në energjinë e ripërtëritshme. Rënia e kapaciteteve prodhuese për lëndët djegëse fosile në Evropë i shtoi edhe më tej këtë ekuacioni. Përveç kësaj, kushtet ekstreme të motit, të karakterizuara nga një verë e nxehtë dhe një dimër i ftohtë, e rritën edhe më shumë konsumin e energjisë dhe, më në fund, pushtimi rus i Ukrainës çoi në mungesën e mallrave energjetike, duke e përkeqësuar edhe më tej krizën dhe në këtë mënyrë e krijoi stuhinë e përsosur.

Kjo stuhi i gjeti të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor të papërgatitura dhe të hapura ndaj luhatjeve të çmimit të energjisë elektrike. Shumica e vendeve varen nga lëndët djegëse fosile për prodhimin e energjisë dhe shumica e qyteteve renditen ndër më të ndoturit në Evropë, gjë që paraqet një tablo të tyre që ngecin në objektivat e tyre të dekarbonizimit. Në vazhden e krizës aktuale energjetike, Serbia dhe Maqedonia e Veriut janë duke e rritur prodhimin e tyre të qymyrit, duke e ngadalësuar edhe më tej tranzicionin energjetik. Me rritjen e tepruar të çmimeve, vendet importuese neto të BP-së janë më të prekurat (p.sh. Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut). BeH dhe Mali i Zi mbeten relativisht të paprekur nga rritja e çmimeve, ndërsa Shqipëria dhe Serbia, edhe pse ende nuk janë prekur, do të goditen nga rritja e çmimeve në dimër. Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria mbeten vendet më të prekura nga ndryshueshmëritë sezonale që i vënë në rrezik kapacitetet e tyre për prodhimin e energjisë elektrike.

Në një përpjekje për ta rritur qëndrueshmërinë ndaj rritjes të çmimeve, vendet e BP6 i kanë ndërmarrë një sërë masash. Duhet të theksohet se numri i masave të ndërmarra nuk e pasqyron nivelin e gatishmërisë së një vendi të caktuar, por thellësinë e krizës në rajon. Sa më shumë që një vend të importon energji, aq më shumë masa ndërmerren. Masat sillen prej kufijve të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme deri te rritja e çmimeve, mbështetja për të varfrit me energji deri te rritja e tarifave, ndërprerjet e energjisë elektrike etj.

Rritjet aktuale të çmimeve ofrojnë një shikim të shpejtë të një të ardhmeje që na tregon se kriza energjetike nuk po shkon askund. Planet dhe strategjitë afatgjata për një kalim të shpejtë drejt burimeve të energjisë së ripërtëritshme duhet të jenë gati. Vonesa në paraqitjen e kapaciteteve të reja të BER-it, dështimi për ta krijuar një mjedis të favorshëm për investorët e BER-it për të zhvilluar projekte dhe vonesa në zgjerimin e burimeve të energjisë e kanë krijuar një situatë problematike për Ballkanin Perëndimor.

Pavarësisht atraktivitetit të tij si opsion për furnizim të sigurt me energji, kthimi në termocentralet me qymyr nuk është opsion i mundshëm për ta përballuar krizën. Një varësi e zgjatur në lëndët djegëse fosile do të vazhdojë ta lërë rajonin të hapur ndaj çekuilibrave ofertë-kërkesë që mund të kthehen në kriza të ardhshme. Kjo do ta pengonte trajektoren drejt energjisë së pastër, duke e dëmtuar shëndetin, produktivitetin dhe ekonominë e vendeve të BP6.

REKOMANDIME

Bashkëpunim më i fortë rajonal ndërmjet gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor lidhur me krizën energjetike (afatmesme).

Duke pasur parasysh që ndërlikimet e rritjes së çmimit të energjisë u ndjenë në shkallë të ndryshme në vendet e BP6, bashkëpunimi më i fortë rajonal duhet të jetë prioritet për të gjitha qeveritë e tyre përkatëse.

Institucionet qeveritare duhet të kërkojnë marrëveshje bilaterale dhe lidhje të mundshme të tregut për t'i përballuar efektet e rritjes së çmimeve.

Krijimi i një burse të energjisë në BP6, të lidhur me HUPX-in, do ta lehtësonte shkëmbimin e energjisë në vendet e BP6 dhe do ta përmirësonte edhe më tej ndërlidhjen dhe bashkëpunimin e brendshëm.

Të rriten investimet në infrastrukturën energjetike, posaçërisht në rrjet dhe ndërlidhje ndërmjet vendeve.

Prezantimi i skemave sociale dhe/ose avancimi i skemave aktuale për t'i mbështetur konsumatorët e varfër me energji dhe për ta parandaluar dëmtimin e mëtejshëm ekonomik për biznese dhe industri të caktuara (afatshkurtër)

Një skemë sociale ku të gjitha familjet me të ardhura të mesme dhe të ulëta do të merrnin shtesa të shkallëzuara, ku familjet me asistencë sociale do të merrnin një shumë më të madhe, pasuar nga grupet e cenueshme (të papunët, studentët, gratë dhe komunitetet e tjera të marginalizuara).

Prezantimi i shtyrjeve për faturat e shërbimeve komunale për komunitetet e prekura nga varfëria energjetike gjatë krizës.

Skema e mbështetjes duhet gjithashtu t'i përfshijë NVM-të dhe sipërmarrësit. Mënyrat për t'i mbështetur kompanitë me energji intensive, qoftë përmes kredive apo subvencioneve, duhet të analizohen dhe zhvillohen edhe më tej.

Prezantimi i stimujve për zgjerimin e mëtejshëm të masave të efikasitetit të energjisë në ndërtesa dhe pajisje për ngrohje/ftohje. Stimujt duhet ta inkurajojnë edhe më tej përdorimin e pompave të nxehtësisë duke i ulur taksat doganore për këto produkte. Duhet të rriten investimet në zgjerimin e sistemeve të ngrohjes qendrore për të mbuluar më shumë konsumatorë.

Rritja e transparencës dhe cilësisë së informimit lidhur me krizën energjetike (afatshkurtër)

Aty ku ka krizë, ka edhe dezinformata. Prandaj, transparenca më e madhe lidhur me krizën energjetike duhet të jetë prioritet për të gjitha qeveritë e BP6. Konsumatorët duhet të informohen në mënyrë të drejtë dhe me kohë për të gjithë trendët e tregut të energjisë dhe masat e mundshme.

Duhet të organizohen fushata vetëdijesuese për masat e efikasitetit të energjisë dhe si të informohemi në mënyrë të drejtë për krizën energjetike vetëm nga burime të sigurtat e kompetente.

Kapacitetet institucionale duhet të ndërtohen dhe forcohen për ta avancuar mbledhjen e të dhënave në sektorin e energjisë dhe të përfshihen të dhëna të ndara sipas gjinisë. Ky veprim është vendimtar për ta kuptuar drejt dhe më pas për të reflektuar për efektet e krizës energjetike në grupet e cënueshme. Këto mbledhje të të dhënave do t'i informonin më tej skemat e mbështetjes sociale dhe duhet të ofrohen në mënyrë të hapur e transparente.

Angazhohuni dhe punoni drejt Agjendës së Gjelbër të Deklaratës së Sofjes dhe Tranzicionit të Drejtë Energjetik (afatgjatë)

Punoni me shpejtësi të madhe drejt qëllimeve të dekarbonizimit. Kjo është mënyra e duhur për parandalimin e efekteve potencialisht shkatërruese të krizave të ardhshme.

Diversifikimi i miksit energjetik në favor të burimeve të energjisë së ripërtëritshme. Ky veprim nuk e kundërshton, por, përkundrazi, e plotëson sigurinë energjetike. Investimet në burimet e ripërtëritshme dhe burimet alternative të energjisë janë një alternativë më e sigurt për t'u përballur me krizat e mundshme në të ardhmen dhe, në planin afatgjatë, ato janë shtesë për sigurinë energjetike të vendeve të BP6. Kjo përfshin veprimet si:

- a) Racionalizimin dhe lehtësimin e burokracisë për të investuar në gjenerimin e BER-it – posaçërisht për sektorin privat dhe familjet – lehtësimi i qasjes së tyre për t'u bërë prosumerë [prodhues dhe konsumatorë]. Kjo do ta mundësonte një rritje të shpejtë në prodhimin e brendshëm dhe një ngadalësim të kërkesës për energji elektrike dhe energji (afatshkurtër).
- b) Krijimin e një strukture më të mirë balancuese për ndërprerjet e BER-it duke nxitur krijimin e kapaciteteve të reja balancuese brenda BP6.
- c) Mbështetjen e rregulloreve lidhur me prosumerët për ta rritur pjesën e tyre të përgjithshme në miksin energjetik duke e thjeshtësuar procedurën e aplikimit.
- d) Rritjen e investimeve për ruajtjen e energjisë.

